



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 03
Prishtinë, më 11 mars 2008
Ndërtesa e Kuvendit, ora 12:00, salla C-301

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Enis Kervan, Ramë Buja, Ramadan Avdiu, Eqrem Kryeziu, Lutfi Haziri, Ibrahim Gashi, Ardian Gjini, Dragiša Mirić ndërsa munguan: Xhavit Haliti dhe Nexhat Daci.

Përfaqësuesi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Hajredin Kuçi.

Pjesëmarrës të tjerë :

Nga zyra e komisioneve të Kuvendit ishin të pranishëm: Minire Hasani, Adelina Demolli dhe Manush Krasniqi.

Petrit Hysaj - OSBE

Hana Bajrami - Qeveria e Kosovës

Mbledhjen e kryesoi Sabri Hamiti, kryetar i Komisionit me këtë :

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Politika e Jashtme e Qeverisë: dëshmia e Përfaqësuesit të Qeverisë së Republikës së Kosovës,**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

2. Politika e Jashtme e Qeverisë: dëshmia e Përfaqësuesit të Qeverisë së Republikës së Kosovës

Sabri Hamiti njoftoi anëtarët e Komisionit se në mënyrë zyrtare i është bërë ftesë përfaqësuesve të Qeverisë së Republikës së Kosovës që të japin orientimet themelore që ka Qeveria për Politikën e Jashtme. Ai tha se sfera e politikës së jashtme ka qenë një sferë e rezervuar gati në mënyrë konservative për disa vite nga UNMIK-u. Lidhur me këtë ai tha se tash pas shpalljes së pavarësisë në këtë fushë duhet të kemi aktivizim më të madh, qoftë në kuptimin e veprimit konkret, qoftë në kuptimin e strukturimit politik, administrativ dhe veprues institucional. Ai shtoi se duhet të reflektoj komunikime ndërinstitucionale që kanë të bëjnë me Presidentin, Qeverinë dhe Parlamentin do të thotë ky komunikim duhet të intensifikohet dhe të bëhet institucional pasi që kjo formë e komunikimit është gjithmonë më e suksesshme sesa dialogimet çfarëdo qofshin përtej institucioneve. Kryetari ftoi zëvendëskryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës z. Hajredin Kuçi që të referoj për temën dhe të jap dëshmitë për veprimet e Qeverisë.

Hajredin Kuçi falënderoi për ftesën dhe në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës prezantoi disa pika orientuese të Politikës së Jashtme të Qeverisë të ndërmarra deri më tani dhe orientimet e mëtejme. Ai tha se Qeveria e sheh shumë të rëndësishme bashkëpunimin me Komisionin parlamentar për Punë të Jashtme dhe me Presidentin e Kosovës në fushën e politikës së Jashtme. Ai tha se si objektiv të parë në këtë periudhë tranzicionale për Qeverinë e Kosovës ka qenë dhe mbetet themelimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme si një institucion efektiv që udhëheq brenda Qeveris marrëdhëniet me jashtë dhe për këtë tha kemi proceduar në Kuvend ligjin për themelimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Lidhur me stafin e Ministrisë së Punëve të Jashtme tha se kemi identifikuar një staf bazë përfshirë edhe përfaqësuesit tonë të jashtëm, kemi bërë sigurimin e zotimeve ndërkombëtare për trajnim dhe trajnim të stafit dhe në këtë drejtim gati kemi arritur marrëveshjen me Sllovenin, Shqipërinë, Austrinë dhe Gjermanin. Ai tha se besojmë se në të ardhmen e afërt disa nga personat tonë që po përgatiten për staf diplomatik do të kenë mundësi që të shkojnë në këto trajnime. Për këtë Ministri tha se kemi ndarë një buxhet shtesë por për misionet diplomatike me rastin e rishiqimit të buxhetit do të ndahet një buxhet plotësues. Misionet diplomatike është menduar ti gjendet zgjidhje në tri drejtime: Duke i siguruar nga buxheti i konsoliduar i Kosovës pra duke i blerë objektet. Me reciprocitet duke ju dhënë mundësi disa shteteve që të marrin toka në Kosovë për të kompensuar në formë të apartmaneve apo të ngjashme në vendet e tyre dhe në formë të donacioneve. Donacionet mund të vijnë nga shtete përkatëse por edhe nga diaspora jonë. Kjo e treta është më pak e sigurt edhe pse kemi shtete sikur se Shqipëria që ka shpreh gatishmërinë për këtë. Si objektiv të dytë tha kemi krijimin dhe ruajtjen e besimit dhe përkrahjes së Grupit Ndërkombëtar Drejtues për Kosovën që është themeluar ditë më parë dhe i cili i dha mandatin Piter Feith që të funksioni në Kosovë dhe me të cilin jemi duke bashkëpunuar ngushtë. Lidhur me obligimet ndërkombëtare të Kosovës që kanë të bëjnë me ligjet që dalin nga pako e Ahtisarit, kushtetutën dhe konventat tjera që kërkohet ti kryej një shtet sovran dhe demokratik ai tha se kemi raportuar dhe po raportojmë vazhdimisht në Grupin Ndërkombëtar drejtues për Kosovën. Një prioritet të madh do të japim vizitës së Ministrave apo edhe zyrtarëve të lartë të vendeve të grupit ndërkombëtar drejtues të cilët vijnë në Kosovë, duke ju dhënë mundësi edhe për pritje në kuptimin serioz por edhe ofrimit të marrëveshjeve bilaterale. Në këtë drejtim tha kemi përgatitur dhe besoj të hënën që vije do ta bëjmë një marrëveshje apo një konventë me shtetin Zvicëran. Lidhur me bashkëpunimin me institucionet ai tha se përveç bashkëpunimit me UNMIK-un, me Misionin e BE-së ne kemi bashkëpunim dhe informim të ndërsjellë edhe me zyret apo ambasadat e huaja në Kosovë. Objektiv i tretë tha është krijimi dhe ruajtja e besimit dhe

përkrahjes se vendeve rajonale. Në këtë drejtim tha se kemi planifikuar që Kryeministri por edhe ministrat adekuat të vizitojnë Maqedoninë, Malin e Zi ndërsa në Shqipëri kanë ndodhur vizita të tilla. Sa i përket Kroacisë tha kemi konfirmimin se brenda javës do ta bëjë njohjen ndërkombëtare të Republikës së Kosovës ndërsa me Bosnje Hercegovinë kemi kontaktet e para por me siguri që njohja do të jetë në proces më të vonshëm. Sa i përket reagimeve që kanë ardhur nga Serbia përball Kosovës tha se kemi qenë të kujdesshëm që të mos reagojmë por kjo nuk nënkupton që politika jonë ka qenë pasive sepse në kanalet diplomatike kemi venë njohurit për veprimet e tilla.

Lidhur me njohjen e shtetit tha se letrat apo kërkesa për njohje iu është dërguar të gjitha shteteve anëtare të OKB-ës të cilat janë të nënshkruara nga Presidenti dhe Kryeministri i Kosovës.

Si objektivi të katërt komunikimi i orientimit të politikës së jashtme të Kosovës brenda dhe jashtë saj. Lidhur me komunikimin e brendshëm tha se kemi nevojë për një komunikim permanent brenda institucioneve të Kosovës siç janë Qeveria, Presidenti dhe Kuvendi i Kosovës dhe mendojmë që këtu duhet ta bëjmë një strategji e cila në radhë të parë duhet të miratohet në institucionet e Kosovës. Një aktivitet i veçantë tha është sigurimi i anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Në këtë fazë ndoshta angazhimi ynë për anëtarësim në OKB-ë është më i ngadaltë por kemi marrë masa të duhura për anëtarësim në Fondin Monetar Ndërkombëtar. Ai tha se kemi dërguar shkresën në Bankën Botërore e besojmë që do ta bëjmë edhe për Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit, Unionin Universal Postar, Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil dhe shumë shpejt me rritjen e numrit të shteteve që do ta njohin Kosovën do ta bëjmë kërkesën për anëtarësim në Unionin Evropian dhe në NATO por me siguri edhe në Kombet e Bashkuara. Ai tha se anëtarësimi në Unionin Evropian është politik nacionalë jo vetëm prioritet i Qeverisë. Ai shtoi se në këtë drejtim jemi në fazën e parë përmes instrumentit të para anëtarësimit, kemi ndarë një buxhet prej rreth 15 milion Euro nga Qeveria e Kosovës këtë vit dhe rreth 125 milion nga Komisioni Evropian. Ky instrument do të ndihmoi në sundimin e rendit dhe ligjit, në gjendjen socio ekonomike dhe në veçanti në plotësimin e standardeve evropiane. Ai njoftoi se këtë të premtë do të jetë prezent Sekretari gjeneral i NATO-s në Kosovë, ku një ndër kërkesat do të jetë edhe mënyra se si Kosova të anëtarësohet në NATO. Sa i përket bashkëpunimit në fushën ekonomike tha se jemi duke tentuar që të rrisim bilancin në mes eksportit dhe importit, ndërtimin e kushteve më të mira edhe të sigurisë por edhe ato legale dhe fiskale për investime të huaja në Kosovë. Po ashtu tha jemi në përgatitje të ofrimit të shërbimeve që ka të bëjë me politikat efektive të protokollit, konsullore dhe ato të vizave. Ndër të tjera nuk kemi pretendime që Kosova të jetë një vend me shumë ndikim politike ndërkombëtare por të kemi një harmoni të plotë brenda për brenda Kosovës dhe Politika e Jashtme të trajtohet si politik nacionalë.

Ibrahim Gashi falënderoi zv.kryeministrin për paraqitjen e objektivave. Lidhur me objektivat e Qeverisë tha se përputhen me objektivat e komisionit për Punë të Jashtme. Sa i përket Ligjit për Ministrin e Punëve të Jashtme tha se kam vërejtur që ka pasur një mirëkuptimi dhe janë inkorporuar disa vërejtje për aq sa ka mundur të modifikohet meqë bëhet fjalë për ligj që del nga Pakoja e Ahtisarit. Ai kërkoi nga zv.kryeministri sqarim se çfarë përmban Grupi Ndërkombëtar për Kosovën që është krijuar tash, cili është misioni i tij dhe sa do të funksionoi ky grup.

Hajredin Kuçi tha se ligji nuk është tërheq pa arsye por ligji ka ndryshime substanciale pozitive. Ky ka qenë edhe qëllimi dhe si Qeveria tha i marrim me kujdes propozimet pozitive të cilat i bëni. Sa i përket Grupit Ndërkombëtar tha se është një grup i cili është i themeluar nga SHBA-të, shtetet anëtare të Unionit Evropian që e kanë njohur Kosovën përfshirë edhe Turqinë dhe Zvicrën. Janë vende që momentalisht duke dashur që t'i ikin ndikimit nga Këshilli i Sigurimit e kanë marrë mandatin për të qeverisur në kuptimin për ti dhënë mandat përfaqësuesit civil ndërkombëtar në Kosovë. Të gjitha ato shtete që njohin Kosovën dhe që janë me ndikim në botë do të marrim pjesë në këtë grup me seli në Vjenë por që është jashtë ndikimit tonë.

Ardian Gjini falënderoi zv.kryeministrin Kuçi për informatat përmbledhëse. Mirëpo tha duke pasur parasysh që Ligji për Ministrin e Punëve të Jashtme nuk është aprovuar ende, cilat janë caqet të cilat ia ka vu Qeveria vetës. Shembull ta marrim sa vende pret Qeveria që ta njohin Kosovën deri në fund të viti ose sa misione diplomatike dhe ambasada parasheh ti hap deri në fund të vitit?

Hajredin Kuçi tha se në fund të vitit kemi mundur që të përcaktojmë konkretisht objektivat tona apo limitet. Ai shtoi se brenda këtij viti kemi bërë një program qeveritar brenda për brenda qeveris. Ai tha se kjo është politik evolutive, e dyta tha kemi aplikuar në 192 shtete dhe presim që të kalojmë numrin 100. Caku ynë për të kaluar numrin 100 është para muajit maj, brenda këtij viti pretendojmë të hymë në Fondin Monetar ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore. Mendojmë që në Union Evropian pasi na njohin 2/3 e shteteve do të bëjmë aplikacionin. Po ashtu tha presim që brenda vitit të gëzojmë njohjen e shteteve të rajonit me përjashtim të Serbisë. Në politiken e jashtme tha presim që brenda vitit të hapim minimum 14 ambasada duke i dhënë mandatin që ndonjë ambasade të përfshijë disa shtete. Sa i përket përfaqësimit tha se në fund të kësaj jave në bashkëpunim edhe me shtete perëndimore do të jetë një përfaqësues i Qeverisë së Kosovës në Konferencën Islamike ku presim njohjen e pjesës dërmuese. Ka një ofertë që ne të anëtarësohemi, ne kemi menduar që momentalisht nuk duhet ta bëjmë një gjë të tillë por duhet të fitojmë njohjen ndërkombëtare e pastaj me kalimin e kohës do të shohim si do të lëvizim. Sa i përket përzgjedhjes së stafit diplomatik ai tha se do të kemi përzgjedhje profesionale dhe do të jenë njerëz që mbrojnë interesat e vendit në arenat ndërkombëtare jo në kuptimin e ngushtë një partiak.

Lutfi Haziri falënderoi për informatat në detaje. Ai tha se e përmendet Këshillin për politik të Jashtme, unë kisha dashur të na sqaroni se çka nënkupton ai Këshill. Kush e mbulon politiken e jashtme? A e mbulon Kryeministri, a e ushtroni ju apo ndonjëri nga ministrat derisa të emërohet Ministri i Jashtëm sepse është me interes që mos të kemi ndonjë zbrastirë. Ai propozoi që Qeveria të bëjë një ofanziv diplomatike duke kërkuar mbështetjen e shteteve partnere që ndihmojnë. Ai po ashtu tha që komisioni duhet të përfshihet në këto politika, në mënyrë që deri në muajin maj numri më i madh i shteteve me finalizua këtë pjesë të angazhimeve.

Hajredin Kuçi tha e dimë se fushën e politikës së jashtme Kosova e ka zhvillu prej viteve të 90-ta, tani po e strukturojmë dhe po e bëjmë në kuptimin shtetëror. Sa i përket Këshillit tha ne e kemi një Këshill që nënkupton jo në kuptimin formal juridik por në vendosjen e misioneve të para diplomatike, vendosjen e njerëzve të parë, kemi menduar që duhet ti përfshijmë bartësit e institucioneve por me siguri me konsultim edhe me shefat e partive politike që janë përfaqësuar në Kuvend. Momentalisht politiken e jashtme tha e udhëheqë Kryeministri në koordinim të plotë me Presidentin. Ndërsa për vendet islamike tha ne kemi pasur dy qasje. E para ka qenë një ngarendje e tyre përballë Kosovës por kësaj qasje ju kemi përgjigjur me logjikën jo që të hyjmë në agjendën e tyre por ata të jenë në agjendën tonë në kuptimin si shtet por edhe si vend dhe e dyta i kemi shfrytëzuar kanalet tona diplomatike në radhë të parë SHBA-te dhe Turqinë që të bëjmë një gjë të tillë. Njoftoi se është marrë ftesë zyrtare për participim në Konferencën Islamike nga Kryetari Gjeneral i Konferencës Islamike dhe se zyrtari i ynë do ta ketë të drejtën e fjalës.

Ramadan Avdiu e vlerësoi lartë këtë formë të komunikimit në mes të komisionit parlamentar dhe përfaqësuesve të Qeverisë. Ai deshi të dijë nëse Ministria e Punëve të Jashtme do filloi konstituimin pas aprovimit të ligjit apo duhet të pritë deri sa të kalohet periudha e tranzicionit. Ai shtoi se në mbledhjen e kaluar të Komisionit u zu në gojë çështja e diasporës e cila ka resurse dhe potencial të cilat do duhej të shfrytëzohen sidomos në lobim. Ai propozoi që të dërgohen aplikacionet në Unioni

e Hekurudhave, pastaj në organizatat kulturore dhe organizatat sportive të cilat janë qendra të forta të lobimit si Komiteti Olimpik dhe FIFA.

Ai sugjeroi që të bëhet aplikacioni në prill në mënyrë që në sesioni vjeshtorë që do të mbahet në shtator Kosova të mund të marrë pjesë në punimet e Asamblesë Parlamentare si anëtare e asocuar.

Hajredin Kuçi shpjegoi se ligjet e aprovuara me procedurën sipas dokumentit të Ahtisarit hyjn në fuqi pas miratimit të Kushtetutës. E dyta tha sa i përket Ministrisë së Punëve të Jashtme, ka të tillë si SHBA-të që mendojnë që duhet ta themelojmë menjëherë Ministrinë dhe ka të tillë që mendoj pas fazës së tranzicionit. Ai tha se anëtarësimi në FIFA dhe Federatat tjera shkojnë përmes Federatave tona ngase ndërhyrja e shtetit në to do të jetë telashe. Por shtoi se ne kemi nxitur Federatën e Futbollit dhe Pingpongut që të bëjnë një gjë të tillë. Sa i përket anëtarësimit në Këshillin e Evropës dhe Union Evropian kemi pas një politik që pa e siguruar një mbështetje të domosdoshme të mos aplikojmë sepse nuk dëshirojmë që ta ngrisim çështjen e Kosovës dhe të refuzohet.

Eqrem Kryeziu falënderoi zv.kryeministrin dhe tha se ky komunikim është shumë i dobishëm. Orientimi i juaj që të kemi njëfar njohje kualitative në bashkëpunim me partnerët e fuqishëm të Kosovës besoj se do duhej me qenë ndoshta pak më agresiv edhe te ky numri kuantitativ.

Ai sugjeroi që të ketë kujdes në trajtimin me korrektësi të investuesve sepse nëse Qeveria sillet me njëfarë lloj shkujdesjeje ndaj interesimit të tyre do të ketë një jehon të keqe sa asnjë diplomat nuk do të mund ta ndërronte këtë imigj prandaj tha le të ketë korrektësi totale me ofertat që vinë dhe me njerëz që kanë përvojë dhe ndikim të jashtëzakonshëm në çështjet politike të vendeve të tyre.

Hajredin Kuçi tha se ne orientimin tonë të parë për hapjen e ambasadave e kemi në vendet që kemi bashkëpunim politik dhe të sigurisë por edhe në vendet që kemi bashkëpunim ekonomik dhe kulturorë. Ndoshta këto janë katër premisa politika, ekonomia, siguria dhe kultura që na lidhin ose kemi nevojë me ato vende të kemi misione diplomatike. Sa i përket prezantimit tha ne kemi hasur një fenomen që ka dy drejtime që na ka penguar. Kemi pasur një grup njerëzve aktivistë të mirë që kanë punuar prej viteve të 90-ta por muajve të fundit sikur kanë harruar se prezantimi i tyre tani më nuk është zyrtar dhe e dyta një prezantim më i madh ndoshta duhet të jetë në kuptimin e lobizimit për gjendjen në Kosovë. Ai shpjegoi se Kosova më shumë është prezantuar qysh janë ardhë të tjerët dhe na kanë parë dhe jo qysh kemi dashur ne me qitë para. Ai tha se jemi duke menduar që në CNN ndoshta edhe në BBC apo diku tjetër ta bëjmë një formë reklamimi në një formë që e avancon Kosovën që edhe në kuptimin e sigurisë po edhe në kuptimin e joshjes për investime ekonomike.

Lutfi Haziri tha se kam dëgjuar një deklaratë tuajën që keni kërkuar prej kabinetit qeveritar që përfaqësimi i politikave duhet të koordinohet dhe të përfaqësohet në mënyrën më të denjë. Ai konsideroi që përmes Kryetarit të Komisionit ka nevojë për një koordinim në mënyrë që të funksionalizohet edhe roli i Komisionit Për Punë të Jashtme. Sipas tij duhet të jetë një koordinim më i mirë, një funksionalizim më i madh në përfaqësim dhe më shumë ndikim në lobim që mund ta bëjë edhe Komisioni vetë me kërkesë të Qeverisë në të gjitha vendet dhe organizatat.

Hajredin Kuçi tha se jemi duke i koordinuar aktivitetet dhe kemi tentuar me i nda përgjegjësit. Ai tha se prioritet i Qeverisë është që të koordinojmë politiken e jashtme me faktorët brenda dhe jashtë vendit. Ai shtoi se një prej faktorëve relevantë është Komisioni për Punë të Jashtme dhe në këtë drejtim Qeveria do të japë mbështetjen e plotë çdo aktiviteti që e bën në kuptimin logjistikë, teknik ose buxhetor.

Sabri Hamiti tha se kjo që kemi bërë sot është puna elementare e komisionit, që të mbikëqyrë politikat e Qeverisë. Ky komision ka punën legjislative në Kuvend atë që e quajmë diplomaci parlamentare që ka të bëjë me asoocimin e Kuvendit në Organizata Parlamentare që i përket Parlamentit, po e ka edhe anën tjetër që ka të bëjë më lidhjen direkt të politikave qeveritare. Sa i përket komunikimeve tha me intereson dhe prandaj kam kërkuar që të takohemi me përfaqësuesin e Qeverisë për këtë që unë e quaj kohë e ndërmjetme. Çka do të bëjnë këto politika në këtë kohë të ndërmjetme që të kemi strukturim të institucioneve e jo atë që e quajë arbitraritet. Ai tha se deri sa të bëhet strukturimi i politikave Këshilli duhet të bëhet strikt në komunikime dhe të bëhet strukturimi me të gjitha kapacitetet. Ai njoftoi se si pikë më ekstreme e komunikimit të Kuvendit është pikërisht ky Komision sepse është gati krejt Kryesia e Kuvendit dhe Shefat e grupeve parlamentare. Ai shtoi se ky ekspozim i Kuvendit të jetë i lidhur edhe me Qeverinë edhe me organin që ju do të quani të ndërmjet. Lidhur me përfaqësimin tha se duhet të gjejmë modusin qysh ti vendosim në disa pika njerëzit që i përfaqësojnë interesat e Kosovës. Ai shpjegoi se puna me njerëz sezonal nuk zgjedh probleme sepse është provuar vitin e kaluar në New Jork dhe nuk ka dhënë produkt. Si disa pika themelore tha shoh Brukselin, Uashingtonin, New Jorku sepse nuk mundemi ne të bëjmë politika globale, ne bëjmë politika të interesit momental, afatmesëm dhe afatgjatë. Si probleme themelore të cilat ne i shtriam sot ishin lobizimi për njohjen, se ne jemi në fazën kur do të na njohin të gjithë ose sa me shume shtete dhe çështjet që kanë të bëjnë më ekonomin. Pra në këto dy tri pika ne është mirë të koncentrohemi në komunikimet e përhershme dhe te gjejmë eksponentin që këto punë ti bëjmë sa ma mirë. Sa i përket lobimin propozoi që Qeveria menjëherë të veproj edhe ne kuptimin e lobimit politik edhe media, të formoj grupin i cili do të krijoj imazhin publik të Kosovës jashtë pasi që ka fuqi të krijoj faqen e fuqishme politike dhe imazhit momental çka donë Kosova para botës. Është mirë që të plasohet diçka që është specifike dhe të plasohet për çdo ditë dhe orë. Dhe në fund tha se komunikimi në mes Komisionit për Punë të Jashtme dhe Qeverisë do të jetë intensiv dhe se do të ftojme përfaqësues të Qeverisë sa herë që te shohim të nevojshme.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00.

Procesmbajtësi
Adelina Demolli

Kryetar i Komisionit
Sabri Hamiti

